

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm-Penal, gjyqtari, Kujtim Krasniqi, në çështjen penale të pandehurit P.M. në P.1 për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 185 par 2 të KPK-së, i akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor- vërejtjes gjyqësore, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.nr.1804/14, të datës 08.01.2016, jashtë seancës, me datë 11.12.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.nr. 1804/14, të datës 08.01.2016shqiptimin e urdhërit ndëshkimor,

Andaj gjykata konformë nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari;

P.M., i ati G. dhe e ëma M., e gjinisë E., i lindur më dt:..., në P.1, rr. "B. e K." nr...., i pamartuar, k., e ka kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptarë – shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

Sepse, ngadatë: 29.01.2014, rreth orës 00:45, i pandehuri nga telefoni i tij me nr...., e ka thirrë në telefonin e të dëmturës Z.V. me nr...., të cilin telefon e kishte pas në posedim e dëmtuara A.D. (pasi që punon te e dëmtuara Z. dhe këtë telefon e mbajnë në lokal), ndërsa ishte lajmruar bashkëshorti i të dëmtuarës A. – D.D., ku i pandehuri fillimisht e ka shajt me fjalë banale e pastaj me qëllim të frikësimit e ka kanosur seriozisht duke i thënë: "gruan të cilën e ka afër dhe Z. ka me i pre me thik, ka me i vra", me ç'rast të dëmtuarave i'u ka shkaktuar frikë dhe ankth, -

-me këtë ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 185 par 2 të KPK-së

Andaj gjykata konform neneve 4, 41, 43, 73 të KPK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Me këtë të akuzuarit i bëhet me dije se nëse prap kryen veprë të tillë penale, gjykata do ti shqiptojë dënim me të rënd.

Obbligohet; i akuzuari që të në emër të shpenzimeve të procedurës dhe atë, në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia kompensoj shumën prej **30 euro**, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari: Z.V. nga P.2 rr. "M.F." nr.... dhe A.D. nga P.2, B. i D., Zona e Lindjes, rr. "H.T." nr...., lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën PP.nr. 1804/14, të datës 08.01.2016, kundër të akuzuarit P.M. nga P.1, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 185 par 2 të KPK-së

Prokurori i qështjes i ka propozuar Gjykatës që kundër të akuzuarit, pa mbajtje të shqyrtimit Gjyqësorë , të lëshoj urdhër ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal, dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i akuzuari vërtet e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron sepas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës ,vie në përfundim se në veprimet e të pandehurës, manifestohen elementet qenësore të veprës penale dhe janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Kanosja nga neni 185 par 2 të KPK-së,për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Penal
P.nr.23/16, të dt. 11.12.2017

Gjyqtari,
Kujtim Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE;

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga marrja e të njëjtit, kësaj Gjykate, pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.